

VENDIM
Nr. 635, datë 27.8.2026

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË
KOORDINIMIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (në vijim Qendra) për shkëmbimin në kohë reale të informacionit dhe lehtësimin e bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare, me përgjegjësi në menaxhimin e integruar të kufirit, kontrollin dhe mbikëqyrjen e tij me qendrat kombëtare të koordinimit të vendeve të rajonit e ato partnere, si dhe me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX).

2. Qendra Kombëtare e Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit është strukturë koordinuese ndërinstitucionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe përbëhet nga përfaqësues të agjencive të zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, si më poshtë vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- c) Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

3. Qendra do të drejtohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

4. Qendra bashkëpunon, për ushtrimin e funksioneve të saj, me Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Rojën Bregdetare dhe institucione të tjera shtetërore, të angazhuara në menaxhimin e integruar të kufirit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shkëmbimi i informacionit dhe prezenca e përfaqësuesve të këtyre institucioneve në Qendër realizohet me kërkesë të Qendrës dhe në përputhje me kompetencat ligjore të secilit institucion.

5. Titullarët e autoriteteve, të përcaktuara në pikat 2 dhe 4, të këtij vendimi, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, caktojnë nga një përfaqësues dhe njoftojnë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pas fillimit të funksionimit të Qendrës, në rast ndryshimi të përfaqësuesit të caktuar, titullari i autoritetit përkatës njofton menjëherë Qendrën.

6. Përfaqësuesit e autoriteteve kombëtare në Qendër kanë akses në bazat shtetërore të të dhënave të institucioneve që përfaqësojnë për kryerjen e detyrave funksionale dhe përgjegjësi, të parashikuara në pikën 2, të nenit 28, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”. Çdo veprimtari ndërhyrëse në të dhënat e sipërpërmendura është e gjurmueshme.

7. Qendra ka akses në të gjitha pamjet e kamerave të instaluara dhe që janë në përdorim nga agjencitë ligjzbatuese që operojnë në kufi, si dhe në sistemin e mbikëqyrjes së kufirit tokësor, detar, përveç sistemeve me qëllim të mirëfilltë ushtarak, liqenor dhe lumor.

8. Informacioni i mbledhur dhe i përpunuar nga Qendra, në përmbushje të detyrave funksionale, administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me rregulloren (BE) 2019/1896 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2019, mbi Rojën Kufitare dhe Bregdetare Evropiane dhe shfuqizimin e rregulloreve (BE) nr. 1052/2013 dhe (BE) 2016/1624, nr. CELEX: 32019R1896, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian nr. L 295/1, datë 14.11.2019, faqe 1–131.

personale, legjislacionin përkatës të bazave të të dhënave shtetërore, si dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

9. Me qëllim hartimin dhe administrimin e raporteve të situatës kombëtare të sigurisë kufitare, si dhe hartimin e shpërndarjen e raportit ditor të aktivitetit ditor, agjencitë e zbatimit të ligjit, që operojnë në kufi, si dhe Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare informojnë Qendrën në kohë reale për çdo situatë apo incident përgjatë kufirit shtetëror tokësor, detar, liqenor e lumor, si dhe në pikat e kalimit të kufirit ajror, tokësor, detar, liqenor dhe do të dërgojnë pranë Qendrës raportin ditor të aktivitetit të shërbimeve përkatëse, të angazhuara në menaxhimin e kufirit.

10. Qendra do të ketë faqen e saj zyrtare, ku do të pasqyrohen informacione dhe kuadri ligjor, nënligjor, në gjuhën shqipe dhe angleze, që lidhen me qarkullimin ndërkufitar të shtetasve e të mallrave.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Roja Bregdetare dhe institucionet e tjera shtetërore, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e integruar të kufirit, sipas kompetencave ligjore përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2027.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi